



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery	08.06.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
STAMSHICK	4634/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.688/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Vjollca Sinani-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.688/2023 të datës 28.04.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë

në , kundër heshtjes administrative të Komisionit të Pranimit në kuadër të Komunes së Prishtinës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 08.06.2023,mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës shpallet Jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.688/2023 e datës 28.04.2023 e parashtruar nga ankuesja

II. Lënda i delegohet për shqyrtim organit kompetent, Komisionit për Ankesave të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Komunën e Prishtinës.

A r s y e t i m

Komuna e Prishtinës më datë 17.01.2023 ka shpallur konkursin me Nr. reference: RN00010772 për emrin e grupit Specialit i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën Zyrtar për Biblioteka 1 pesë pozita, ku afati për aplikim ka qenë nga data 07.02.2023 deri më datë 14.02.2023. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila fillimisht sipas Vendimit të datës 20.02.2023 i është refuzuar aplikacioni për shkak që nuk ka plotësuar kushtet e konkursit , mirëpo pas ankesës së saj e njëjta është përfshirë në listën e verifikimit paraprak. Më datë 05.03.2023 ankuesja është

njoftuar nga Burimet Njerëzore të Komunës së Prishtinës se testit me shkrim do të mbahet me datës 07.03.2023 nga ora 14:00, ndërsa sipas emailit të datës 06.03.2023 të orës 15:43 ankuesja është njoftuar nga Burimet Njerëzore të Komunës së Prishtinës për ndryshimin e orarit të testit me shkrim nga ora 14:00 në orën 11:00.

Ankuesja më datë 09.03.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 14-070/01-0050849/23 me të cilën ka kërkuar nga komisioni të rishikohet konkursi për Specialit i Administrimit të Përgjithshëm, ndërsa në të njëjtën ditë me datë 09.03.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2523/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër këtij procesi, mirëpo Këshilli përmes Vendimit A.nr.476/2023 të datës 24.04.2024 ka hedhë poshtë si të palejuar ankesën e ankueses.

Ankuesja më datë 28.04.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3912/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër heshtjes administrative ndaj mos shqyrtim të ankesës së datës 09.03.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Prishtinës. Ndërsa Këshillit më datë 11.05.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me provat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 3912/2023 e datës 28.04.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për kërkesë apo ankesë i datës 09.03.2023; Vendimin e datës 20.02.2023 i Menaxherit të Personelit; Emailin e datës 21.02.2023 nga SIMBNJ për ankuesen; Listë të verifikimit paraprak e datës 22.02.2023; Njoftimin për testin me shkrim për ankuesen i datës 05.03.2023 dhe 06.03.2023 nga Burimeve Njerëzore; Njoftimin e datës 04.04.2023; Konkursin e datës 17.01.2023 me Nr. reference: RN00010772 për emrin e grupit Specialit i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën *Zyrtar për Biblioteka 1 pesë pozita*; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.05.2023; Përgjigjen në ankese e datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 14-020/04-0047502/23 i datës 06.03.2023 për përbërjen e Komisionit të Pranimit; Njoftimin e datës 20.02.2023, 27.02.2023; Listën e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar; Njoftimin e datës 14.04.2023; Aplikacionin e ankueses i datës 07.02.2023; Certifikatën e datës 13.04.2022; Diplomën me Nr. 2518; Vërtetimin e datës 07.02.2023; Diplomën me Nr. 689; Ankesën me numër protokollit 14-070/01-0050849/23 të datës 09.03.2023 të parashtruar nga ankuesja në Komunën e Prishtinës; Komunikimet mes . dhe . të datës 12.05.2023; Informatën e datës 19.05.2023 nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës; Kërkesën për informata zyrtare e datës 23.05.2023 e dërguar për Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Përgjigjen e datës 31.05.2023 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga ankuesja dhe organi i punësimi dhe ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesja, *sepse*:

Ankuesja në ankesën e parashtruar më datë 18.04.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se fillimisht më datë 05.03.2023 ka njoftuar për mbajtjen e testit me shkrim, ndërsa më datë 06.03.2023 ka bërë ndryshimin e orarit të testit me shkrim, si rrjedhojë njoftimi nuk është bërë së paku 48 orë para mbajtjes së testimit, po ashtu nuk është shqyrtuar ankesa e datës 09.03.2023 por është vazhduar me konkursin pa dhënë asnjë përgjigje lidhur me ankesën time.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi që ka pranuar të gjithë materialin nga Komuna e Prishtinës, si organ që ka zhvilluar procedurë, më datë 19.05.2023 nga Menaxheri i Personelit ka pranuar informatën se zyrtarët e pranuar sipas konkursit me Nr. reference: RN00010772 janë në marrëdhënie punë në Bibliotekën "në" i cili është institucion kulturorë në vartësi të Komunës së Prishtinës, referuar njoftimit të lartshënuar në lidhje me vendin e punës së këtyre zyrtarëve, më datë 23.05.2023 kemi kërkuar informata zyrtare edhe nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme si organë kompetentë për definim të kësaj qështje sa i përket statusit të këtyre zyrtarëve publik, nëse kjo pozitë sipas këtij konkursi është pozitë e nëpunësit të shërbimit civil apo pozitë e nëpunësit të shërbimit publikë, ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 31.05.2023 ka njoftuar që pozita *Zyrtar për Bibliotekë* kanë statusin e zyrtarit publikë përkatësisht të *nëpunësit të shërbimit publikë*.

Duke marr për bazë informatën nga organi i punësimit respektivisht udhëheqësit të burimeve njerëzore të komunës së Prishtinës se të pranuarit sipas këtij konkursi do të jenë në marrëdhënie punë në Bibliotekën "në" dhe përgjigjen e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme si organë kompetentë për administratë publike të datës 31.05.2023, Kolegji i Këshillit, poashtu konstaton se sipas pikës 9 të konkursit me Nr. reference: RN00010772 tek fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen kandidatët janë: Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjet e tjera përkatës që rregullojnë Drejtorinë e Kulturës dhe Sektorin e Bibliotekave, andaj përkitazi me këtë Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, i'u referua edhe Ligjit Nr. 04/L-097 për Bibliotekat përkatësisht nenit 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, i cili ka përcaktuar se: "Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: 1.1. Bibliotekat - Institucione kulturore, arsimore dhe informuese që mbledhin, ruajnë, përpunojnë dhe vënë në dispozicion të përdoruesve koleksionet e veta, ofrojnë qasje të lira në informacione në cilat do forma që janë depozituar", nenit 5 paragrafi 2 i cili ka përcaktuar se: "Sipas funksionit, veprimtarisë dhe varësisë së tyre, bibliotekat publike klasifikohen në këto lloje: 2.1. Biblioteka Kombëtare e Kosovës; 2.2. biblioteka komunale; 2.3. biblioteka universitare; 2.4. biblioteka shkollore; 2.5. bibliotekat e veçanta".



Duke marr parasysh dispozitat e lartcekura, Kolegji i Këshillit, konstaton se Biblioteka Komunale , hyn në kuadër të institucioneve të kulturës, artit si dhe shërbimeve tjera të ngjashme publike, rrjedhimisht lidhur me statusin e marrëdhënies së punës së kandidatëve të përzgjedhur sipas konkursit me Nr. reference: RN00010772 për pozitën *Zyrtar për Biblioteka*, Kolegji i Këshillit i' u referua edhe Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht: nenit 2 paragrafi 2, i cili përcakton se: *"Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës"*, ndërsa paragrafi 4 i këtij neni përcakton se: *"Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike"*.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në këtë, konstaton se meqenëse kandidatët e përzgjedhur sipas konkursit me Nr. reference: RN00010772 për pozitën *Zyrtar për Biblioteka*, do të jenë të punësuar në kuadër të Bibliotekës në atëherë sipas dispozitave të lartcekura dhe sqarimeve të mësipërme nga organet kompetente kjo pozitë nuk hyn në kuadër të pozitave që kanë statusin e nëpunësit të shërbimit civil por kjo pozitë hyn në kuadër të pozitave që kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publikë, kështu që në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e *nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil*, andaj pas konstatimit se kjo pozitë nuk ka statusin e nëpunësit civil por të *nëpunësit të shërbimit publikë*, Kolegji i Këshillit vlerëson së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent që të shqyrtoj ankesat lidhur me kontestet e marrëdhënies së punës të nëpunësve të shërbimit publikë, kështu që mbi këtë bazë, Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses, ngase Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas Vendimit A.nr. 177/2021 të datës 29.04.2021 në lidhje me këtë kategori të njëjtë të nëpunësve ka vendosur për të punësuarit në Bibliotekën , me që rast i njëjti vendim është vërtetuar edhe nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative përmes aktgjykimit A.nr.1213/21 të datës 10.03.2023.

Marr parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.688/2023 të datës 28.04.2023, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës të konfirmuara nga organet kompetente vërehet se ankuesja ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës duke parashtruar ankesë më date 09.03.2023 me numër protokollit 14-070/01-0050849/23, dhe në këtë mënyrë konfirmon jokompetencën e këshillit në këtë çështje, atëherë kolegji i këshillit duke mos u lëshuar në përmbajtje të konkursit për shkak që pozita që i referohet ankuesja nuk ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil dhe me qenë se ankuesja ende nuk ka marrë vendim nga komisioni i ankesave që i është adresuar ankesa , duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për


Ankesa të Nëpunësve të Shërbimit Publikë në Komunën e Prishtinës, ngase e drejta e ankimit për kontestet e marrëdhënies së punës për pozitat e nëpunësit e shërbimit publik është rregulluar me dispozitat e nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente”* dhe nenit 74 paragrafit 1 të këtij ligji, i cili përcakton: *“Zyrtari i shërbimit publik mund të ankohet të punëdhënësi kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës”*, ndërsa nëse pala është e pakënaqur me vendimin e organit të punësisimit mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente siç parashihet me nenin 74 paragrafin 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.688/2023, datë 08/06/2023

Vjollca SINANI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Komisionit për Ankesa të Nëpunësve të Shërbimit Publikë në Komunën e Prishtinës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

